



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT Durrës

Nr. 472/prot.
16

Durrës, më 08.10.2025

VENDIM

Nr. 15 datë 08.10.2025

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NE BUXHETIN E KËSHILLIT TË
QARKUT Durrës PËR VITIN 2025


Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Nr.23 datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027,faza e Tretë” për Këshillin e Qarkut,Vendimit Nr.22,datë 26.12.2024 “ Mbi miratimin e Buxhetit Vjetor për vitin 2025.”si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Durrës:

VENDOS

1. Të miratojë ndryshimet në Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025, si më poshtë:

Të ardhurat e Këshillit të Qarkut gjithsej 174'279'168 lekë

Nga kjo	- Transferta e pakushtëzuar	55'243'101 lekë
	- Të ardhurat vendore	43'000'000 lekë
	- Të ardhurat të trashëguara	51'014'459 lekë
	- Të ardhurat nga fondet e BE-së	25'021'608 lekë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT Durrës

Shpenzimet e Këshillit të Qarkut gjithsej 174'279'168 lekë

Nga kjo : Funksionet e veta nga granti, të ardhurat dhe nga trashëgimia:

- Për administratën e Këshillit të Qarkut	30'482'000 lekë
- Për shpenz operative e vend gjyqësore	19'489'560 lekë
- Për shpërblimin e antarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut.	936'000 lekë
- Për investime në Këshillin e Qarkut	2'400'000 lekë
- Për investime Rikonstruksion rrugët "Perandori Hadrian dhe Kandavia"	39'850'000 lekë
- Për Shpenz. Operative per Projektet, nga fondet e BE-së	22'598'191 lekë
- Për Shpenz. në investime per Projektet, (blerje pajisje zyre,informatike etj.,)nga fondet e BE-së	2'423'417 lekë
- Për investime "Rikonstruksion rruga Aristoteli dhe sistemim-asfaltim rruga Shekspir & Arzenta,Bashkia Durrës"	52'600'000 lekë
- Për fondin rezervë	3'500'000 leke

- 1.Të miratojë ndryshimet në pasqyrat e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025, të cilat i bashkangjiten këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financë-Projekteve, Burimet njerëzore, DAMT dhe të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut dhe Dega e Thesarit Durrës.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

